



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 35/4 prot.

Datë 12.01.2023

V E N D I M
Nr. 25/ 2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.01.2023, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 35/2023 prot., datë 11.01.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-52984-12-12-2022, me objekt “*Përmirsime, riorganizime, integritet dhe zhvillime të reja të platformës zyrtare në institucion*” me fond limit: 7,488,277 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Instant.AI” SHPK
Adresa: Rruga Idriz Dollaku, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë
Sheshi Skënderbej 2, Tirana 1001
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020

“Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.12.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-52984-12-12-2022, me objekt “*Përmirsime, riorganizime, integritet dhe zhvillime të reja të platformës zyrtare në institucion*” me fond limit: 7,488,277 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 10.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankesa me nr. A/2023/2815 protokolluar me nr. 35 prot., datë 11.01.2023, e operatorit ekonomik “*Instant.AL*” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 11.01.2023 “*Formularin për Publikim*” Nr. 35/2 prot., datë 11.01.2023.

II.3. Në datën 12.01.2023, operatori ekonomik ankimues “*Instant AL*” SHPK, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ka paraqitur një kërkesë protokolluar me nr. 35/3 prot., datë 12.01.2023 me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-52984-12-12-2022, me objekt “*Përmirsimi, riorganizimi, integrimi e zhvillimi të reja të platformës zyrtare në institucion*” me fond limit: 7.488,277 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “*Instant AL*” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-52984-12-12-2022, me objekt “*Përmirsimi, riorganizimi, integrimi e zhvillimi të reja të platformës zyrtare në institucion*” me fond limit: 7.488,277 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë, para përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimesin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës A/2023/2815, me nr. protokollit 35/2023, datë 11.01.2023 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë

ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-52984-12-12-2022, me objekt “*Përmirsimi, riorganizimi, integrimi e zhvillimi të reja të platformës zyrtare në institucion*” me fond limit: 7,488,277 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Instant Al*” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

